

## VASKË MILKANI

VËZHGIME MBI TË FOLMEN E BULGARECIT (Fushë e Korçës)<sup>1</sup>

Qëllimi i kësaj skice dialektore është që të japë veçoritë kryesore të së folmes të katundit Bulgarec të rrethit të Korçës.

Bulgareci ndodhet në veriperëndim të qytetit të Korçës në të djathtë të rrugës automobilistike Korçë-Tiranë, afërsisht 5 km. larg qytetit. Duke e marrë Bulgarecin si qendër të një elipsi, mund të japim këtë pozitë gjeografike të tij. Në lindje ndodhet Korça, në verilindje tokat e tij takohen me ato të katundit Çiflik dhe me ato të Shamollit, në veri me tokat e NBSH Maliq dhe të Rovit. Në perëndim kufizohet me Biranjin e Vashtëminë, në jugëperëndim me Melçanin e Lumalasin, kurse në jugë lindje me Turanin.

Përsa i takon prejardhjes së banorëve dhe kohës së vendosjes së tyre në këtë vend, shumë informatorë pleq nuk ishin në gjendje të jepnin të dhëna. Ata dinin se jetonin aty edhe gjyshërit e tyre. Disa familje kanë ardhur tani vonë nga krahina të tjera të zonës së Korçës, sidomos pas Reformës agrare.

Në kohën e sundimit otoman e më pas, banorët e këtij katundi janë marrë kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Veç kësaj në katund është e njohur edhe puna e të endurit me vegje, që kryhet kryesisht nga gratë, gjë që të bije në sy edhe sot në shtëpitë e bulgarecarëve. Aty-këtu, më tepër si një shfaqje sporadike, ka pasur ndonjë fshatar që ka ushtruar edhe profesionin e mullixhiut edhe të zdrukthtarit. Popullsia e Bulgarecit para çlirimit, ashtu si edhe në kohën tonë ka ndjekur tregun e Korçës. Banorë të këtij katundi, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, kanë shkuar para çlirimit edhe në kurbet, kryesisht në Amerikë dhe në Australi. Bulgarecarët kanë lidhur krushqi kryesisht me fshatrat fqinjë të fushës së Korçës dhe me Korçën, por në ndonjë rast ata kanë kaluar edhe më larg, bile deri në Devoll, Kolonjë, Floq, Polenë, Bellovodë etj.

Mbas çlirimit, si kudo në vendin tonë, edhe në Bulgarec filloi një jetë e re. Bulgareci sot ka 245 shtëpi dhe një popullsi prej 1350 banorësh. Në tetor të vitit 1948 u themelua kooperativa bujqësore dhe në vitin 1950 ishte kryer 97% e kolektivizimit. Sukses për kooperativistët e këtij katundi ka qenë edhe ndriçimi i fshatit me dritë elektrike qysh në vitin 1953.

1) Ky punim u përgatit së pari si temë diplome nën udhëheqjen e shokut Jorgji Gjinarit me titullin «Vëzhgime mbi sistemin morfologjik të së folmes të katundit Bulgarec» dhe u mbrojt në qershor të vitit 1964. Pasi shtuam edhe kapitujt: Fonetikë e Sintaksë, e përpunuam edhe një herë në bazë të vërejtjeve të shokëve të Sektorit të gramatikës e të dialektologjisë në formën që po e paraqesim.

Bulgareci, duke qenë gjithmonë pranë Korçës, ka pasur dhe ka lidhje të shumanshme me qytetin. Sot Bulgareci ka një ekonomi bujqësore dhe blegtorale mjaft të zhvilluar, me një nivel të mirë arësimor e kultural (shumica e brezit aktiv ka mbaruar 7 ose 8-vjeçaren). Rreth 80-85% e familjeve sot kanë radio. Shtypi shfrytëzohet në të gjithë llojet e tij. Bulgareci sot ka një shkollë 8-vjeçare me 400 nxënës e 17 arësimtarë, kinemanë me 400 vende, shtëpinë e kulturës me disa salla, çerdhe e kopsht fëmijësh, banjë-lavanderi të re, furrë, menci, infermieri, rrobaqepësi, kovaçanë, mulli me korent, biçikletari, zdrukhttari, punishten e marmallatës dhe dyqane të ndryshme. Pranë shtëpisë së kulturës ndodhet një bibliotekë mjaft e pasur me letërsi politike, shkencore dhe artistike (përveç bibliotekës së shkollës dhe bibliotekave personale të mjaft anëtarëve të kooperativës). Këto pak të dhëna tregojnë edhe një herë për ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në katundin Bulgarec, ndryshime që kanë ndikuar edhe në ngritjen kulturele të banorëve të tij.

\*

E folmja e Bulgarecit për herë të parë po bëhet objekt i një vëzhgimi dialektor. Materialin e kemi mbledhur gjatë muajve korrik-gusht 1963. Duke dashur të kapnim të folmen tradicionale të fshatit, morëm si informatorë subjekte të brezit të vjetër. Kështu, përshkrimi, që do të bëjmë ne, nuk do të japë plotësisht të folmen e sotme, në dinamikën e saj, me ndryshimet që po ndodhin në brezin e ri. Gjatë mbledhjes së materialit gjuhësor në vend kemi pyetur katërmbëdhjetë subjekte, ndër to edhe disa gra të ardhura nga fshatrat fqinj të fushës së Korçës, sepse krushqitë që bëhen brenda për brenda fshatit janë të rralla.

Si metodë pune kemi përdorur kryesisht bisedën e lirë, por, kur gjatë kësaj bisede disa nga format gramatikore nuk na dilnin, kemi përdorur edhe formën pyetje-përgjigje. Shpeshherë format gramatikore i regjistronim në dy a më shumë subjekte, për të parë qëndrueshmërinë apo lëvizjen e tyre. Në mbledhjen e materialit gjuhësor ne u kufizuam vetëm në katundin Bulgarec, sepse kjo gjë na lejonte të kapnim më mirë të folmen e fushës së Korçës nëpërmjet gjurmimit më të thelluar në një fshat të saj. Përveç bisedës me subjekte me moshë 50-90 vjeç kemi vëzhguar edhe të folurit e brezit të ri, me qëllim që të vërenim ndryshimin me brezin e vjetër dhe prirjen kryesore të zhvillimit të së folmes. Duke qenë nga Korça, kemi pasur mundësinë që materialet e mbledhura t'i kontrollojmë edhe t'i plotësojmë.

## FONETIKË

### T h e k s i

1. Theksi në këtë të folme paraqitet si në toskërishten e përgjithshme. Në fjalët turke ose të marra nëpërmjet saj, theksi, si edhe në gjuhën nga janë marrë, bie në rrokjen e fundit: *pará, kafé, dairé, mezé, teskeré, vallaí, bilaí, teneqé, okllaí*. Fjalët *básmë, shíshe, tenxhére,*

*shamátë* janë paroksitone. Fjalët *ai, atë, këtë, disa* të fondit të gjuhës shqipe janë oksitone si në gjithë dialektin tosk, bile edhe kur shërbejnë si mbiemra: *atë gjë, dë këtë aurt*.

#### Zanoret në rrokje të theksuar

2. Zanorja *â*. Kjo e folme, ashtu si gjithë toskërishtja, e ka kthyer në *ê* zanoren *â* që ndodhet para bashkëtingëlloreve hundore, edhe në rastet kur këto kanë rënë ose janë rotacizuar: *dhëmbi, dhëndër, gjël-përë, lëmi, gërshërë, mëngë, këngë, thënë, dhënë, lënë, zënë*.

Edhe zanorja *a* para bashkëtingëlloreve hundore te fjalët turke, është kthyer në *ê*: *musëndër, kalldrëm, llagëm*: kurse te fjalët *aksham, taman, Osman, sallam, pishman*, ka mbetur e pandryshuar.

3. Zanorja *e*. Zanorja *e* e theksuar që gjendet para bashkëtingëlloreve hundore, nuk është kthyer në *ê*: *embër, e enjte, e premte, fembër, zembër, pendë, fre, qen*. Por nuk mungojnë në këtë të folme edhe raste, megjithëse më të pakta, kur një *e* tillë *e* si në shumë të folme të toskërishtes kthehet në *ê*: *gjëmbi, mëndje, vënt, vënë*.

4. Zanorja *y*: Në sistemin e fonemave të kësaj të folmeje bën pjesë edhe zanorja *y*, e cila, siç dihet, mungon në disa të folme të dialekteve jugore dhe veriore: *gjysma, yll, pyll, sy, dy, mbyll, qymyr, atyre, këtyre*.

U vu re se në disa rasa kjo zanore ka ardhur si rezultat i palatalizimit të zanores së prapme buzore *u*: *sëndyq* (sënduq), *yshqime* (ushqime), *yve* (juve).

#### Zanoret në rrokje të patheksuar

5. E folmja e Bulgarecit, si shumë të folme të tjera të krahinës së Korçës, e ka ruajtur zanoren *ê* të patheksuar në shumë pozita.

Pavarësisht nga numri i rrokjeve që ka fjala, zanorja *ê* fundore është ruajtur, kur fjala është paroksitone: *mirë, shumë, degë, mashë, bukë, lugë, supë, udhë, mbrëmë, jashtë, shpinë* (shtëpinë), *brumë, djathë*. Zanorja *ê* fundore zakonisht ruhet edhe te emrat e formuar me prapashtesën *-zë, qershizë, dorëzë, lajthizë, kufizë, bulëzë, kokrizë, faqezë, fushëzë*.

Zanoren *ê* e gjejmë të ruajtur edhe në fjalët proklitike: *në lumë, në dhjamrat, më shpi, më tha, të punosh, të jap, të them, të keqen; në mbiemrat si; dhe në ndajfoljet që u përgjigjen këtyre mbiemrave: i butë, i drejtë, i gjatë, i fortë, e lartë, e mirë; ftotë, gjatë, shëndoshë, vonë, qartë, ngrotë*.

Zanorja *ê* paratheksore, pavarësisht nga numri i rrokjeve që ka fjala ruhet: *këtu, lëkurë, gëzoj, misërishte, gëdhënt, kushëriri, dëborë, vetëtinte, mëkat, këput, këpucë, bagëti, mësoj*. Në disa fjalë kjo *ê* atone e ndodhur para theksit bie: *vllanë, spatën, misrok*.

Nuk ndihet *ê*-ja fundore zakonisht te fjalët proparoksitone *uthull, kumbëll*.

Në ndonjë fjalë zanorja *ê* paratheksore ka dhënë *i*: *gjilpërë* (gjëlperë).

6. Zanorja *i*: Sa herë që kjo zanore ndodhet pranë një zanoreje

të theksuar, e humb vetinë si rrokjeformuese dhe bëhet komponente e diftongut të formuar prej saj dhe zanores së theksuar fqinje: *babqi, ftqi, shkqi, prqi, martqi, e çpqi*.

### Togje zanoresh

7. Në grupin e zanoreve *ua* theksi bie mbi zanoren *u*: *thúa, ftúa, dúa, grúa, u martúa, u rëzúa*. Megjithatë kur grupi zanor *ua* ndodhet në rrokje të mbyllur, dëgjohet aty-këtu si diftong: *thuán, ftuán, kuajt, i martuar, duar*.

Emrat që mbarojnë me *-uall* në trajtën e shquar e kthejnë togun zanor në diftong: *buall - bualli, shuall - shualli, truall - trualli*.

Vërejmë të njëjtën gjë edhe për grupet e zanoreve *ye* dhe *ie*: *krýe, u thýe, u lýe, u kthýe, shpíe, shtíe, díe*. Por dëgjohet edhe *pyet, dyer, fyell, diell, mbiell, ziej, tier*.

### Bashkëtingëlloret

8. Bashkëtingëllorja *h*. Në të folmen e Bulgarecit kjo bashkëtingëllore sidomos në krye të fjalës nuk ndihet: *ëna* (hëna), *ëngra* (hëngra), *undavec* (hundavec), *ipa* (hipa), *të ajë* (të hajë), *unj* (hunj), *atere* (atëhere), *muabet* (muhabet), *të ziemi* (të zihemi), *laem* (lahem), *lyem* (lyhem), *aem* (haem), *ziem* (zihem), *bëem* (bëhem), *mbaem* (mbahem), *thaem* (thahem), *gjuá* (gjuha), *duan* (duhan), *reat* (rehat), *ndimë* (ndihmë), *shëroet* (shërohet), *bëet* (bëhet), *piet* (pihet), *ple* (pleh), *sho* (shoh), *njo* (njoh), *muamedan* (muamedan), *koë* (kohë).

9. Bashkëtingëllorja *nj* është ruajtur në të folmen e Bulgarecit, kur ajo është:

a) në rrënjë të fjalës: *një, njeri, njerjë, rënjë, binjakë, e enjte*.

b) në mbaresën e shumësit të emrave e mbiemrave: *mullinj, unj, qirinj, penj, gjunj(ë), ftonj, thonj, cironj, kallinj, bastanxhinj, çifçinj, musullxhinj, priftinj, lumenj, lëmçinj, lëminj, të mëdhenj*.

c) në mbaresën e trajtave foljore të së pakryerës: *qepnja, këputnja, flisnja, ngrinja, pinja*. Kur është në mbaresën e trajtës foljore të kohës së tashme, u vu re se ajo është zhvilluar më tej dhe ka dhënë bashkëtingëlloren *j*: *bëj, shij, lyej, laj, fshij*.

10) Bashkëtingëllorja paragjuhore *rr* nuk bën pjesë në sistemin e fonemave të kësaj së folmeve, ashtu si dhe në të folmen e qytetit të Korçës, të rrethit të saj dhe të shumë qyteteve të jugut. Këtu ekziston vetëm bashkëtingëllorja *r*: *rënjë, rip, mar, rugë, sharë, zjari, nxjer, rallë, ralloj, rethoj, rjetë, riskë, rotë, rush*.

Kuptohet, vetvetiu, se në të folmen e Bulgarecit, ashtu si dhe në të folmen e Korçës janë bërë homonime çifte fjalësh të tilla: *vare* (=vare-ja) -*vare* (varre) dhe *vare* (trajta e urdhërores së foljes «varur»), *ara* (arra), dhe *ara*; *ra* (rrah) dhe *ra* (aoristi i foljes «rënë»), *të rinë* (mbiemër i substantivuar «i riu» në kallëzore) dhe *të rinë* (lidhore e tashme veta III shumës).

11. Grupet *mb, nd, ng* në këtë të folme kanë mbetur të tilla në të gjitha pozitat:

a) *mbush, mbiell, mbleth, këmbë, pëllëmbë, gjëmbi, shkëmb, më dhëmb*;

b) ndaj, ndenja, paramendë, pendë, mën'ije, tund, shkund, vënd, sëndyq, efendinë;

c) ngul, nga, ngriet, spango, lëng, ngrinja, ngarkovi, çengel, kam ngrënë.

Vërehen, edhe raste të reduktimit të grupeve *mb*, *nd*, po vetëm te parafjalët, ku përkatësisht kanë dhënë *b*, *d*: *Kemi punuar bë një fambrikë; dalim bë udhë; kam patur katër vëllezër dë Amerikë; më parë ishte dë Kavajë; tashti është dë Durës; dë siklet të madh jam; dë shtëpi; e përcolla dë shkurt e dë buzë të marsit; lonte de pusi; isha de dajua; kam sjellë edhe lopën de dera; i vinte de krevati; qenë dëpër shpitë.*

12) Në këtë të folme ndryshe nga të folmet e Oparit, Skraparit dhe Beratit, nuk kemi kthimin e *n*-së përpara *gj*-së në një tingull qiellzor hundor *nj* për shkak të tingullit që ka pas: *qengji, ngjit, u ngjall, ngjevi, ngjavi.*

### Fenomenet fonetike

13. *Shurdhimi*. — Edhe në të folmen e Bulgarecit, si dhe në shumë të folme të tjera të jugut, kthehet në të shurdhët një bashkëtingëllore e zëshme që ndodhet në fund të fjalës ose në rrokje të mbyllur para një bashkëtingëllores tjetër të shurdhët *t*, *k* por edhe para *m*, *n*: *plump, dhëmp, heth, breth, zgjeth, elp, u doq, zoq, i math, rjeth, u kalp, funt, rogos, mës, zok, arthke, derthte, tuntke, brothmë, lithmë.*

14. *Asimilimi*. — Nga asimilimi i plotë vokalik u vërejtën vetëm disa rasa: *fingjilli* (fëngjilli) *z dua, z bëj* (s'dua, s'bëj).

Grupet *rn, tn, thn, lln, sn* janë asimiluar dhe kanë dhënë *r, t, th* (dh), *ll, z*: *mbrenë* (mbretnë), *bulmenë* (bulmetnë), *shuallë* (shuallnë), *ungjillë* (ungjillnë), *buallë* (buallnë), *tanë* (të jatin), *zananë, fshanë, bregaderë, shoferë, lakrorë, aberë, mbyllë, lihtë, duallë, thirë, mblo-dhë, muarë, suallë, zbrazë, ndezë.*

15. *Fenomeni i shtesës*. — Duhet të përmendim se në këtë të folme te emrat femërorë oksitonë të shquar midis zanores fundore dhe nyjes së prapme shquese lind shpesh një bashkëtingëllore për të prishur hiatin: *druja, dynjaja*. Por në mjaft rasa kjo bashkëtingëllore nuk ndihet: *mbau, largau, vraeni, lau, qeveria, xhamia, bëu, liria.*

Kemi herë-herë protezë të një bashkëtingëllores hundore *m* para *b* e *n* para *t*: *mbesoj* (besoj), *u ntrash* (u trash). Karakteristike janë rastet e epentezës. Kështu del një bashkëtingëllore hundore *m* a *n* para një bashkëtingëllores buzore ose dhëmbore: *fambrikë, andresë, ambulancë, njëndizaj*. Ose epentezë të bashkëtingëllores *b* në mes të grupit *mr*: *dimbri, zembra, thembra, fembra, embri.*

16. Vihen re në këtë të folme edhe raste sinkopash të një tingulli a të disa tingujve: të *nesmet* (të nesërmen), *kshu* (kështu), *arç* (arthsh), *tashi* (tashti), *ashu* (ashtu), *shpi* (shtëpi), *qumshi* (qumështi), *pasaj* (pas-taj), *çar të bëj* (çfarë të bëj), *mja* (mjaft), *më të sipmet* (më të sipërme), *diçshkurtri* (ditëshkurtëri).

17) *Kontraksioni*. — E gjejmë këtë fenomen fonetik, kur pranë bashkëtingëllores ë të patheksuar ndodhet një zanore çfarëdo e theksuar dhe si rezultat i këtij fenomeni ka dalë një zanore e gjatë, e cila është po ajo zanore e gjatë që ka pasur fjala: *zishin* (ziheshin), *rë-zoshin* (rrëzoheshin), *ndashin* (ndareshin), *bëshin* (bësheshin), *korat* (kohërat).

## MORFOLOGJI

## Emri

## 1. Gjinia

Në këtë të folme hasen në përdorim edhe emrat e gjinisë asnjënëse, të cilët, siç dihet, sa vjen e po zhduken në mbarë shqipen.

a) emra të gjinisë asnjënëse që tregojnë lëndë: *grurët, ujët, jonxhët, leshtë, mishtë, gjalpët, brumët*.

b) emra të prejardhur nga pjesorja e foljeve ose nga mbiemrat: *të raurit, të lindurit, të shirit, të zitë, të kuqtë*.

Këta emra, shumica emra lënde, përdoren në këtë të folme edhe si emra të gjinisë mashkullore: *leshi, dhalli, mjelli, gjalpi, mjalti, djathi, vaji*; dhe relativisht dendur edhe si emra të gjinisë femërore: *jonxha, e vojtura nuk kish të mbaruar; e nxeta, gjalpa, djatha, mjalta, uja*.

Të përdorur si emra të gjinisë asnjënëse kemi hasur edhe emrat: *turitë, kryet*.

## 2) Trajta

a) Emrat që në të pashquar mbarojnë me togun zanor *ua*, kur shquhen nxjerrin përsëri në dritë *o-në* e dikurshme në vend të diftongut: *ftua-ftoj, thua-thoj, përua-proj*;

b) Emrat që mbarojnë me *-uall*, ndryshe nga të parët, në trajtën e shquar e kthejnë togun zanor në diftong dhe marrin nyjen e prasme shquese *i*: *buall-bualli, shuall-shualli, truall-trualli, u yri bualli* dhe *jonxhët; u gris shualli*.

Ndërsa emrat që mbarojnë me *-or, -tor* nuk e kanë zbërthyer zanoren *o* të prapashtesës: *puntor, lakror, qershor*.

c) Emrat mashkullorë, që dikur kanë pasur një *n/r* në temë dhe që sot, në të pashquarën, mbarojnë me zanore të theksuar, trajtën e shquar e formojnë duke nxjerrë *n/r* e dikurshme të temës dhe duke marrë njëkohësisht edhe nyjen e prapme *i*: *peri, syri, kufiri, mulliri, gjuri, freri, zëri, uri, kushëri*.

Në këtë mënyrë e formojnë trajtën e shquar edhe disa emra që në të pashquarën mbarojnë me zanore të theksuar: *ulliri, qiriri, trari, dheri*.

ç) Emrat *babá, pashá, daí*, kur shquhen marrin nyjen e gjinisë mashkullore *i* ose *u*. Por te një subjekt i veçantë (i lindur dhe i rritur në Bulgarec dhe me origjinë familjare po nga fusha e Korçës) këta emra në trajtën e shquar dolën në formën: *pashau, bába, bába do ta epte se s bënte*.

## 9) Numri

Një numër i madh emrash mashkullorë e formojnë shumësin duke i shtuar temës së njëjësit mbaresën *-ë*: *partizanë, muamedanë, gjermanë, kazanë, tavanë, fustanë, baxhanakë, konakë, bardhakë, jatakë*,

*kulakë, lakrorë, doktorë, dasmorë, puntorë, firarë, tuxharë, antarë, ushtarë, gomarë, imonikë, petanikë, byrekë, çyrekë, fyshekë, trëndafilë, mësusë.*

Mënyrë tjetër e formimit të shumësit të emrave mashkullorë mjaft e përhapur është ajo me mbaresën *-e*: *ugare, vakte, saçe, sinore, kanale, pazare, viçe, vënde, gjynae, alle, allate, zakone, llafe, xhepe, grazhde, nishane, vare, adete, fise, kontrolle, yshqime.*

Me mbaresën *-ra* e formojnë shumësin emra, si: *nipra, mbretra, ballistra, fshatra, urovra, dhjamra, bishtra, dushkra, bereqetra, lymra, mishra, pilafra.*

Disa emra kanë të njëjtën trajtë si për njëjësën e shumësin *ca kufi, dy shpirt, pesë grosh, katër muaj.*

Emrat mashkullorë, që në numrin njëjës dalin me temë në bashkëtingëlloret prapagjuhore *k, g, e* formojnë shumësin:

a) me palatalizmin e *k* në *q*: *bujk-bujq, mik-miq, peshk-peshq, turk-turq, krushk-krushq.* Disa emra të këtij grupi marrin edhe mbaresën *-e*: *dushk-dushqe, oxhak-oxhaqe, endek-endeqe.*

b) me palatalizmin e *g* në *gj* plus mbaresën *e*: *burg-burgje, plug-plugje, damalug-damalugje, dyfek-dyfege.* Dy emra të këtij grupi e formojnë shumësin edhe me metafoningimin e zanores së rrënjës: *breg-brigje, shteg-shtigje.*

Me mbaresën *-a* e formojnë shumësin një numër i vogël emrash: *bura, tryela, krimba, plepa, lisa, lepura, ripa, filma, çengela, doktora, napolona.*

Një pjesë e këtyre emrave e formojnë shumësin edhe me *-ë*. Kështu kemi hasur: *doktorë-doktora, napolonë-napolona, çengelë-çengela.*

Disa emra, tema e të cilëve mbaron me bashkëtingëlloren *ll*, në shumës e kanë palatalizuar atë në *j* dhe ndonjë prej tyre merr edhe mbaresën *-e*: *buall-buaj, bandill-banditj, brumbull-brumbuj, kungull-kunguj, mangall-mangaj, bakall-bakaj, pyll-pyje.*

Shumica e emrave mashkullorë, që dikur kanë mbaruar me *n* dalin me *nj* në emëroren e pashquar shumës: *mullinj, unj, penj(ë), gjunj(ë).* *Nj* marrin në shumës edhe disa emra që mbarojnë me zanore të theksuar ose dyzanor: *ftonj, thonj, cironj, ullinj, kallinj, çifçinj, bostanxhinj, musullxhinj.* Me mbaresën *-enj* (*-ënj, -inj*) e formojnë shumësin emrat: *lumenj, fukarenj, qeratenj, gjarprinj, priftinj, lëmçinj.*

Për formimin e shumësit përdoret edhe prapashtesa turke *-llarë* (kur zanorja e rrënjës është *a*) dhe *-lerë* (kur zanorja e rrënjës është qellzore) kryesisht për emra të huajtur nga turqishtja: *baballarë, qalllarë, hoxhallarë, agallarë, ustallarë, bejlerë, shelerë.*

Një grup emrash që zakonisht tregojnë frymorë e formojnë shumësin me mbaresën *-ër*: *nip-nipër, mbret-mbretër, evlat-evlatër, gjysh-gjyshër, skllav-skllavër, kunat-kunetër.*

Emrat e mëposhtëm trajtën e shumësit e formojnë në mënyrë të parregullt: *kalë-kuaj, vëlla-vllezër; djalë-djem; njeri-njerëz, thes-thasë.*

Emrat e gjinisë femërore e formojnë shumësin në këtë mënyrë:

a) me mbaresën *-a*: *motra, shkolla, dardha, kumblla, opinga, dreka, piperka, fanella, sofrë, kaurka, trapeza, kupa, pula, rosa.*

b) me mbaresën *-ra*: *gostira, bakllavara, luftra, meselera, punëra, tepsira, tregëtira, fuqira, binara, historira, gjëra, shamatra, rëmuja.*

c) duke ruajtur të pandryshuar trajtën e njëjësit: *mollë, qepë, buzë, qeramidhe, naze, kulaçe, thërime, rënjë, farë, kobure, cigare, pendë, çorape, javë, lule.*

Emrat *dorë, derë* e bëjnë shumësin *duar, dyer.*

#### A) *L a k i m i*

Në rasën gjindore-dhanore njëjës, kemi gjetur vetëm tri raste kur nyja e prapme i shtohet drejtpërsëdrejti temës së emrit të gjinisë mashkullore: *si në gjë të birt të mbret; i thotë të birt; i tha të shoqt.*

Rasa gjindore-dhanore shumës e trajtës së shquar është e njëjtë me atë të trajtës së pashquar, dmth. nuk ndihet nyja e prapme *t*, karakteristike për trajtën e shquar: *de udha e rogozave; ce ay u thoshte këtyre grave se është ujt e çezmave.*

Rasën kallëzore, emrat mashkullorë të numrit njëjës, që mbarojnë me zanore të theksuar ose diftong, e formojnë në trajtën e shquar duke marrë mbaresë-nyjën *-n* drejtpërsëdrejti pas temës së emrit të pashquar: *babanë, kanë, ustanë, gjanë* (gjahun), *myshterinë, njerinë, ftuan(ë), përuan, thuan.*

Emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore e formojnë trajtën e shquar të kallëzores duke marrë drejtpërsëdrejti pas temës mbaresë-nyjën *-në*. Shumë herë kjo mbaresë-nyje, duke qenë në kontakt me bashkëtingëlloret *l, t, r, n*, është asimiluar vetë ose ka asimiluar bashkëtingëlloren e temës: *kollozheknë, Dunavecnë, çifliknë, bajraknë, plisnë, Maliqnë, shoknë, Isufnë, vathnë, suratnë, ushqimnë, mbretnë, shuallë, mallë, ungjillë, buallë, zananë, bulmenë, fshanë, bregaderë, lakrorë, gjemberë, shoferë, kryetarë, kushërinë, kufinë, tavanë.*

Në këtë të folme nuk mungojnë as rastet kur në rasën kallëzore të trajtës së shquar del një zanore anaptitike *i* ose *u* sipas rastit, midis temës e mbaresë-nyjes *n*: *leshin, gishtin, panxharin, vaktin, vëndin, misrin, truallin, allin, dyfegun, barkun, peshkun, fatin.*

Kjo gjë, sipas nesh duhet të ketë rrjedhur si rezultat i ndikimit të gjuhës së shkruar, sidomos këto vitet e fundit. Në të mirë të kësaj flet edhe përdorimi i dendur i rasteve të para nga brezi i vjetër. Në lidhje me raportin e përdorimit të kësaj dukurie mund të themi shkurt se prirje zhvillimi ka forma letrare, e cila përdoret dendur nga brezi aktiv i popullsisë, dhe nën këtë ndikim të shfaqet jo rrallë edhe te brezi i vjetër.

*E ashtuquajtura trajtë vendore.* Ashtu si në të gjitha të folmet e Toskërisë Veriore dhe të Shqipërisë së Mesme, edhe në këtë të folme, në sistemin e rasave, bën pjesë edhe e ashtuquajtura trajtë vendore, që është formuar nga kallëzorja e pashquar me nyjen *t*.

Karakteristikë për këtë të folme është përdorimi i dendur i kësaj trajte. Siç dihet emri në këtë trajtë është i shoqëruar nga parafjalët *ndë, dë, nëpër, më, në, me, për*: *mësoj me atë Gaqon dë senatorumt; doli dë ballkont; dë prakt; lindje dë aurt; dë xhept; ndë mest, ndë penxheret; idhe ndë atë kazant, nëpër baltët, e kishnë më samart; do t'i vinte në resht; e kam dë bostant; në atë çiflikt; në grykët, në mest; ta shuaj n gropt; me sqepart; të vjen keq për djalët; ajo u zu për litart.*

Ndonjëherë midis temës e nyjes së prapme *t* shfaqet një *i* ose *u* anaptitike përgjithësisht tek emrat që u mbaron tema me një grup bashkëtingëlloresh, për të lehtësuar shqiptimin e pamundur të tri bashkëtingëlloreve që do të takoheshin në rast të kundërt: *më vjen lopa dhe misrit; ndër grazhdit, ta prisnin kokën në burgut.*

Hasim edhe raste, ku duket se kësaj trajte *i* ka zënë vendin kallëzorja: *ostenë e kam dhe arë; dërgon në furë djalën; më shpi do veç; vinje në mal; gjer të vinje më shpi; tu shtiesh më grazhd.*

Rasa rrjedhore. — Në këtë të folme në rasën rrjedhore shumë të pashquar kemi zakonisht trajtën me *-ve* identike me të gjindore-dhanores. Por në mjaft raste hasim edhe trajtën me *-sh*: *Si ta ulin nusen, i venë tri shapka pe djemsh; pas tri javësh erdhi ushtëri tjetër; pas ca ditësh ky Isufi polli një djalë me këtë Fatimenë; janë lidhur për undësh.*

## NYJA

Në të folmen e Bulgarecit, si në të gjitha të folmet e Shqipërisë Jugore, në një togfjalësh të përbërë prej një emri të shquar dhe një mbiemri të nyjshëm, ose prej një emri përsëri të shquar dhe një emri në rasën gjindore, kemi elidimin e nyjes së prapme *i* të emrit të shquar mashkullor dhe *a* të emrit femëror: *shuall' i këpucës, qen'i kallanxhiut, sinor'i Çifligut, shul'i prapmë, bëri mal'e bardhë përpjetë s'e linte fustan'i shkretë, kal'i Shabanit, jaz'i mullirit, dher'i djegur, oficer'i parë, der'e priftit; duket për analogji edhe nus'e madhe, nus'e vllajt.*

## PËREMRA T

### 1. Përemrat vetorë.

Përemri vetor i vetës së parë njëjës, në rasën emërore ka trajtën *unë*: *unë kam dalë i pari; unë do ta kullos.*

Në numrin shumë, veç trajtës letrare *ne* të rasës emërore, në këtë të folme, si në shumë të folme të jugut, përdoret dendur trajta e gjindore-dhanores *neve*: *neve do të djegim shtëpitë; neve rinim ndër funt; neve e kemi bërë; neve ashtu barësnim.* Trajta *neve* haset e përdorur edhe në rasat kallëzore dhe rrjedhore: *me neve ardhni dhe ay; pa neve sbëet gjë; pe neve kanë dalë shumë partizanë.*

Po ky fenomen ndodh edhe me përemrin vetor të vetës së dytë shumë *ju*, i cili shpesh përdoret me trajtën e gjindore-dhanores *yve* në rasën emërore, kallëzore dhe rrjedhore: *yve shkelni, yve lani, yve natë e ditë këtu ngorthni; me yve e ndërnuam Shqipërinë; pe yve pritet e mira.*

Përemrat vetorë të vetës së dytë dhe të tretë njëjës *ti, ay*, ka raste që në rasën emërore njëjës të hasen me trajtat *tinë, aynë*, si duket për analogji me përemrin vetor të vetës së parë njëjës *unë*: *tinë ke një motër; as unë as tinë; tinë më e mirë se Zylkadeja; tinë je në shkollë o; moj po tinë ç më kujton; kur ishte aynë në Korçë, isha edhe unë.* Po ashtu në rasën kallëzore më ndonjë rast hasim edhe trajtën *tynë*; *e dërgon te tynë.*

Trajtat e shkurtëra kanë përdorim të dendur me foljet e mënyrës urdhërore, në të dy pozicionet proklitik e enklitik. Trajta e shkurtër

është në pozicion proklitik sa herë që para kësaj vjen një folje tjetër me të cilin formon një togfjalësh ose kur ka përpara një pjesëzë mohuese dhe është në pozicion enklitik në rastet e tjera: *del i thua*, *çap i bini*, *mbathe*, *mere zjeje*, *thuamë*, *iqmë*, *shikoe*, *prite*, *mos e lerë*, *le të na japë*; *mos e ri*, *mos më bjerë*. Trajta e shkurtër *del* edhe në mes të foljes së mënyrës urdhërore: *pyeteni*, *thuamëni*.

Për t'u përmendur ndër bashkimet e trajtave të shkurtëra janë: *ua* (<u + e); *jau* (<u + e); *na i* (na + e); *s ua kishmë frikën*, *ua kalovi*, *jau fshinin shpinë*; *jua prisnin kokën*, *ti mund të na i mbarosh këtë punë*.

## 2. Përemrat dëftorë

Si në gjuhën e përgjithshme, kur bëhet fjalë për frymorin a sendin që gjendet afër, përdoren përemrat *ky* për gjininë mashkullore dhe *kjo* për gjininë femërore dhe *ai* e *ajo* për frymor a send të largët. Rrjedhorma ka si trajtë atë të dhanores.

## 3. Përemrat pyetës e lidhorë:

Gjetëm në përdorim këta përemra pyetës: *cili*, *çë*, *çarë* (por edhe: *çuarë*), *çfarë*, *kush*, *sa*, *se*, p.sh. *cili Thoma?* *cili ka ngrënë jonxhë?* *ç është ay?* *ç bëre ti?*, *çarë bën kështu me Sofkë?* *çarë ra aty?* *çuarë ti rëfejme çuarë bëri diçkurtëri* (ditëshkurtëri) *çfarë thua?* *kush je ti?* *kush dolli?* *sa ishin?* *me se punonin?*

Përemri pyetës *çarë*, *çuarë* te brezi i vjetër përdoret pothuajse në të njëjtën masë, kurse brezi i ri përdor më dendur formën letrare *çfarë*, pa munguar ndonjëherë edhe ndikimi i traditës.

Përemri lidhor i palakueshëm që përdoret relativisht dendur: *ipa të Sotirit që është më e lartër: janë gjëra që s'i dimë*.

Përdorim kanë edhe përemrat e pacaktuar *kush*, *ç*, *ça*, *çfarë* (*çarë*, *çuarë*).

## 4. Përemrat e pakufishëm

Si përemra të pakufishëm që tregojnë frymorë e sende në mënyrë të pacaktuar përdoren: *kush*, *sikush*, *nonjë*, po edhe *ndonjë*, *njëri*, *cilado*, *secila*, *secili*, *aksecili*, *çdo*, *diçka*, *xheç* (me kuptimin e përemrit të pakufishëm *diç*), *tjatër* (por edhe *një tjetër*, si duket nga ndikimi i gjuhës së shkruar), *njëri*.

Veç këtyre përdoren edhe përemrat e pakufishëm që tregojnë sasi të pacaktuara frymorësh a sendesh: *ca*, *disa*, *xhesa* (me kuptimin e përemrit të pakufishëm *disa*), *një palë*, *një parë*, *një takëm*, *një tufë*, *kaq*, *aq*, *shumë*, *pak*, *gjithë*, *të gjithë*, *tërë*, *të tërë*. Hasëm gjithashtu edhe përemrat e pakufishëm me kuptim mohor: *asgjë*, *asnjëri*.

## 5) Përemrat pronorë:

Përemrat e mbiemrat pronorë vetvetorë, në këtë të folme nuk përdoren si në gjithë të folmet e tjera të jugut. Këtë funksion e luajnë përemrat pronorë jo vetvetorë të vetës së tretë.

Këtu poshtë po japim tabelën e lakimit të mbiemrit pronor të vetës së parë e të dytë në numrin njëjës e shumës, kur prona e pronari janë njëjës e shumës të gjinisë femërore e mashkullore.

Duhet shtuar akoma se dhe në këtë të folme mbiemri pronor, kur shoqërohet me emra të farefisnisë, rri zakonisht përpara tyre: *yt atë*. Por kemi gjetur edhe një rast kur mbiemri pronor i numrit shumës rri përpara emrit: *timë motra*.

### *Lakimi i mbiemrit pronor*

#### Veta e parë

##### 1. Pronari njëjës.

#### *Prona e gjinisë mashkullore*

1) «Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. kali tem	djemtë tem
Gj.Dh. kalit tem	djemve tem
Kall. kalin tem	djemtë tem

#### *Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. lopa teme	çupat teme
Gj.Dh. lopës teme	çupave teme
Kall. lopën teme	çupat teme

##### 2. Pronari shumës

#### *Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. kali tonë	djemtë tonë
Gj.Dh. kalit tonë	djemve tonë
Kall. kalin tonë	djemtë tonë

#### *Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. masha tonë	çupat tona
Gj.Dh. mashës tonë	çupave tona
Kall. mashën tonë	çupat tona

## II. Veta e dytë

### *Pronari njëjës*

#### *Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. gishti tënt	djemtë tënt
Gj.Dh. gishtit tënt	djemve tënt
Kall. gishtin tënt	djemtë tënt

*Prona e gjtnisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. çorapja tënde	çorapet tënde
Gj.Dh. çorapes tënde	çorapeve tënde
Kall. çorapen tënde	çorapet tënde

*Pronari shumës**Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. djali tuaj	djemtë tuaj
Gj.Dh. djalit tuaj	djemve tuaj
Kall. djalin tuaj	djemtë tuaj

*Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. çupa tuaj	çupat tuaja
Gj.Dh. çupës tuaj	çupave tuaja
Kall. çupën tuaj	çup <sup>a</sup> tuaja

*Lakimi i përemrit pronor**Veta e parë**1. Pronari njëjës**Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. temi	temit
Gj.Dh. temit	temëve
Kall. temin	temit

*Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. temja	temet
Gj.Dh. temes	temeve
Kall. temen	temet

*Pronari shumës**Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. toni	tonit
Gj.Dh. tonit	tonëve
Kall. tonin	tonit

*Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. tona	tonat
Gj.Dh. tonës	tonave
Kall. tonën	tonat

II. *Veta e dytë**Pronari njëjës**Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. tëndi	tëndit
Gj.Dh. tëndit	tëndëve
Kall. tëndin	tëndit

*Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. tëndja	tëndet
Gj.Dh. tëndes	tëndëve
Kall. tënden	tëndet

*Pronari shumës**Prona e gjinisë mashkullore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. tuaji	tuajt
Gj.Dh. tuajit	tuajve
Kall. tuajin	tuajt

*Prona e gjinisë femërore*

«Prona» njëjës	«Prona» shumës
E. tuaja	tuajat
Gj.Dh. tuajës	tuajave
Kall. tuajën	tuajat

Siç shihet edhe nga tabela, mbiemrat pronorë të përdorur në këtë të folme në mjaft raste janë të ndryshëm nga ata të gjuhës letrare.

Gjëja e parë që të bie në sy në paradigmën e këtij lakimi është se mbiemrat pronorë kanë formë të njëjtë në të gjitha rasat, domethënë edhe rasia emërore është e njëjtë me rasat e tjera. Kjo duhet të ketë ardhur si rrjedhim i përhapjes analogjike të rasave të zhdrejta në rasën emërore.

Kështu te mbiemri pronor i vetës së parë e të dytë, trajta e kallëzores përdoret jo vetëm në rasën emërore, por edhe në rasën gjin-

dore-dhanore. Kjo formë ka kaluar dhe është përdorur edhe kur pronari është njëjës e prona shumë. Gjithashtu forma e mbiemrit kur pronari është shumë e prona njëjës e gjinisë mashkullore ka kaluar dhe është përdorur edhe për mbiemrin ku prona është shumë (*kali tonë, djemtë tonë*).

## F O L J A

### Forma veprorë

#### Mënyra dëftore dhe kohët e saj:

a) Koha e tashme. — Foljet me bashkëtingëllore të zgjedhimit të parë<sup>2</sup> në vetat e numrit njëjës dalin pa mbaresë:

unë qep	shkel	breth
ti qep	shkel	breth
ay qep	shkel	breth

Foljeve me *-t* të zgjedhimit të dytë, në këtë të folme, u qëndron e pandryshuar tema kur janë të klasës së parë, kurse foljeve të klasës së dytë të këtij zgjedhimi tema u mbaron me *s* në vetën e parë njëjës dhe në tri vetat e shumës.

unë këput	fut	flas
ti këput	fut	flet
ay këput	fut	flet

Por ka edhe raste kur u mbaron tema me *s* në vetën e parë njëjës dhe në tri vetat e shumës foljeve të klasës së parë të këtij zgjedhimi: unë *ujis, godis, ti ujit, godit*.

Foljet, tema e të cilave mbaron me bashkëtingëllore, në numrin shumë marrin mbaresat *-im, -ni* dhe *-in*. Por nuk janë të rralla as rastet, kur foljet e zgjedhimit të parë për vetën e parë e të tretë të shumës kanë mbaresat *-ëm, -ën*: *mbjellëm, edhëm, marëm, sjellëm, mbjellën, erdhën*.

Për zgjedhimin e dytë kemi hasur vetëm në një rast mbaresën *-ëm* dhe *-ën* për vetën e parë dhe të tretë të shumës: *lozëm, lozën*.

Foljet e zgjedhimit të tretë në vetën e parë njëjës dalin me mbaresën *-j*, ndërsa në vetën e dytë dhe të tretë me mbaresën *-n*.

unë bëj	shij	lyej
ti bën	shin	lyen
ay bën	shin	lyen

Foljet e zgjedhimit të katërt në vetën e parë, të dytë e të tretë njëjës dalin pa mbaresë, me zanoren tematike të gjatë:

unë pī	flē	zē
ay pī	flē	zē
ti pī	flē	zē

<sup>2</sup>) Për ndarjen e foljeve në zgjedhime kemi marrë për bazë klasifikimin që u ka bërë prof. K. Cipo në *Gramatikën shqipe*, Tiranë 1949.

Në numrin shumëfoljet e zgjedhimit të tretë kanë mbaresat *-(j)më, -ni, -j(në)*, kurse ato të zgjedhimit të katërt *-më, -ni, -në*:

ne *kthëjmë, bëjmë, shimë, lajmë, flemë, pimë,*  
yve (ju) *ktheni, bëni, shini, lani, flini, pini,*  
ata, ato *kthejnë, bëjnë, shinë, lajnë, flenë, pinë.*

Foljet ndihmëtare *kam, jam* zgjedhohen kështu në të tanishmen e dëftores:

*kam, ke, ka, kemi, kini, kanë; jam, je, është, jemi, ini, janë.*  
Dhe folja ik: *ikinj, ikën, ikën, ikim, ikni, ikin*

Folja *thom (them)* merr këto trajta në vetat e ndryshme të njëjësit e të shumësit: *thom* ose *them, thua, thotë, themi, thoni, thonë.*

Zgjedhimi i disa foljeve të parregullta e gjysëm të rregullta në të folmen e Bulgarecit është si vijon:

*vij, vjen, vjen, vimë, vini, vinë*  
*vete, vete, vete, vemë, vini, venë*  
*dua, do, do, duam(ë), doni, duan(ë)*

b) *Koha e pakryer* — Të gjitha foljet në të pakryerën e dëftores në tri vetat e njëjësit kanë mbaresat *-nja, -nje, -te (nte)*:

unë *qepnja, shkelnja, iknja, këputnja, flisnja, shinja, ngrinja, pinja,*  
ti *qepnje, shkelnje, iknje, këputnje, flisnje, shinje, ngrinje, pinje,*  
ay *qeppte, shkelte, ikte, këputte, fliste, shinte, ngrinte, pinte.*

Tri vetat e shumësit kanë mbaresat: *-nim, -nit, -nin*:

ne *shkelnim, iknim, këputnim, flisnim, shënim, ngrinim, pinim, qepnim,*  
yve(ju) *shkelnit, iknit, këputnit, flisnit, shënit, ngrinit, pinit, qepnit,*  
ata, ato *shkelnin, iknin, këputnin, flisnin, shënin, ngrinin, pinin, qepnin.*

Foljet ndihmëse *kam* e *jam* zgjedhohen kështu: *kisha, kishe, kishte* (edhe *kish*) *kishim* (edhe *kishmë, kishëm*), *kishit, kishnë* (edhe *kishin, kishnin*), *isha, ishe, ishte, ishim* (edhe *ishmë*), *ishit* (dhe *ishtë*), *ishin* (dhe *ishnë*).

#### *Koha e kryer e thjeshtë (aoristi)*

Karakteristikë për këtë të folme është trajta e vetës së tretë e numrit njëjës, të foljeve në zanore, në të cilat ndërmjet temës dhe mbaresës futet bashkëtingëllorja antihiatizuese *v*. Kjo trajtë ka një përdorim relativisht të dendur: *shivi, lavi, pivi, shtrovi, arovi, kërkovi, pastrovi, kalovi, vravi, previ, krevi, qavi, dërgovi, lëshovi, këndovi.*

Por ka edhe raste kur midis temës e mbaresës nuk del bashkëtingëllorja antihizuese *v*: *shiu, vrau, preu, lau, theu, trazoi, kërkoi, martoi, shkoi, filloi.*

Kjo lëkundje, për mendimin tonë, vjen si rezultat i ndikimit të gjuhës së shkruar. Kështu te brezi i vjetër kemi mbizotërimin e trajtës me *v*, kurse te brezi i ri kjo lëkundje është më e theksuar, p.sh. ka raste që i njëjti informator që i përket brezi të ri për të njëjtën folje ka përdorur edhe trajtën me *v* e atë pa *v*.

Foljet e parregullta dhe foljet e zgjedhimit të parë, që të kryerën e thjeshtë e formojnë me apofoni, kanë këto trajta: *vajti, ardhi, vuri, doli, mori, shpuri, zuri, ndënji, ëngri*. Kemi aty-këtu edhe ndonjë rast kur veta e tretë njëjës e së kryerës së thjeshtë del pa mbaresë: *ay oq dorë; ay mbet; s'mbet mbret pa ardhur*.

Foljet të cilave u mbaron tema me bashkëtingëllore, kanë në të kryerën e thjeshtë për tri vetat e shumësit mbaresat *-më, -të, -në: oqmë, lithmë, ngritmë, gjezdismë, brothmë, ikmë, këputmë, aritë, gostittë, qeptë, shkeltë, brohtë, foltë, këputtë, qepnë, humpnë, plakosnë, krisnë, iknë, gjezdisnë*.

Në disa raste, kur mbaresat së bashku me bashkëtingullore hundore të temës nuk formonin grupe bashkëtingëlloresh që asimilohen, mbetën dy bashkëtingëllore që mbyllin rrokjen fundore të fjalës. Prandaj edhe këtu, ashtu si në shumë fjalë të tjera të shqipes, lindi nevoja për daljen e një zanoreje ë në mes të këtyre bashkëtingëlloreve, ndaj sot, disa folje me bashkëtingëllore kanë mbaresat *-ëm, -ët, -ën*.

Kemi edhe raste kur grupet e bashkëtingëlloreve në kontakt janë asimiluar në vetat e shumësit, sidomos në vetën e tretë: *mbyllë, lidhë, duallë, thirë, mblodhë, muarë, suallë dhe sollë*. Për dy foljet e fundit kemi të përdorura edhe trajtat *muar* e *suall*, ku pas asimilimit të grupeve *-rn, -lln*, ka rënë edhe zanorja *ë* e ndodhur në pozicion fundor si *më muar nuse, vanë muar nga ca tërshërë, më suall një çarçaf*.

### *Koha e ardhme*

Për kohën e ardhme përdoren dy trajta. E para është për nga origjina një futur volitiv i formuar me pjesëzën *do* dhe *lidhoren*. Pjesëza të e mënyrës lidhore disa herë nuk ndihet: *më shpi do veç; do veç ndë furt; do març nusen; do shkoj nesër Korçë; do bëj: do vish; do flenë*. Por në shumë raste, sidomos kur është e bashkuar me trajta të shkurtëra, pjesëza të e lidhores ndihet: *do të allosësh, do të pyesësh, do të ajë, do ta pyesë, do tu them, do ti ndimojmë, do ta kullosë*.

Trajta e dytë formohet nga tipi me vlerë paskajore me pjesëzën parafjalore për dhe forma gramatikore e foljes ndihmëse *kam* në të tashmen e mënyrës dëftore. Folja ndihmëse në këtë rast zgjedhohet rregullisht sipas vetës e sipas numrit. Kjo trajtë është më pak e përdorur se e para: *kam për të shkuar Korçë; kemi për të vajtur dë dhjarmrat; kam për të arnuar robot; kemi për të blerë grurë; kam për të vajtur; kam për të vaditur bostanë*.

### *Forma pësore*

#### a) *Koha e tashme*

Mbaresat vetore për kohën e tashme njëjës të mënyrës dëftore janë *-em, -esh -et*. (Këto edhe për foljet në temë me zanore a me n). Bashkëtingëllorja epentetike antihiatizuese *h* nuk del, siç ndodh për-

gjithësisht në gjuhën shqipe: *qepem, zhdrykem, këputem, laem, bëem, lyem, aem, ziem, qepesh, zhdrykesh, këputesh, laesh, bëesh, lyesh, aesh, ziesh, qepet, zhdryket, këputet, laet, bëet, lyet, aet, ziet.*

Mbaresat e shumësit janë *-emi, -eni, -en*. Për vetën e dytë shumës në disa raste kemi edhe mbaresën *-i*.

ne	<i>qepemi, këputemi,</i>	<i>laemi</i>
yve(ju)	<i>qepi, këputeni edhe këputi,</i>	<i>lai</i>
ata, ato	<i>qepen, këputen</i>	<i>laen</i>

ne	<i>aemi</i>	<i>mbaem</i>	<i>ziem,</i>
yve(ju)	<i>ai dhe aeni</i>	<i>mbai dhe mbaen,</i>	<i>zi dhe zieni</i>
ata, (ato)	<i>aen,</i>	<i>mbaen,</i>	<i>zien</i>

### b) Koha e pakryer

Mbaresat e së pakryerës për tri vetat e njëjësit janë: *-(e)sha, -(e)she, -(e)she*. Te foljet që dalin me zanore, si rregull midis mbaresës dhe temës, duhet të dilte bashkëtingëllorja *h*. Por në këtë të folme, siç është thënë edhe më parë, kjo bashkëtingëllore nuk ndihet.

unë	<i>qepsha,</i>	<i>zhdryksha,</i>	<i>futsha,</i>	<i>pëlqesha,</i>	<i>zisha,</i>	<i>lasha</i>
ti	<i>qepshe,</i>	<i>zhdrykshe,</i>	<i>futshe,</i>	<i>pëlqeshe,</i>	<i>zishe,</i>	<i>lāshe</i>
ay	<i>qepshe,</i>	<i>zhdrykshe,</i>	<i>futshe,</i>	<i>pëlqeshe,</i>	<i>zishe,</i>	<i>lāshe.</i>

Siç shihet, te foljet me bashkëtingëllore s'del e para mbaresës së mirëfilltë, ajo mund të ketë rënë. Po kështu ajo e ka rënë edhe te foljet ku tema e së pakryerës mbaron me *i* (*zisha < ziesha < zihesha*). Ka raste kur zanorja *e* e mbaresës *-(e)sha* nuk ndihet, sepse pasi është kthyer njëherë në *ë* është shkruar në zanoren e temës. Për shkak të këtij kontraksioni është zgatur zanorja e temës (*lasha, lāshe, lāshe*).

Kemi gjetur edhe raste, kur për vetën e tretë të numrit njëjës përdoret mbaresa *-ej*: *qepej, mbaej, emroej, mentoej, mbaroej*. Këto raste janë më të rralla në përdorim. Një lëkundje e tillë nuk është veçse një shfaqje sporadike, e ardhur duket nga ndikimi i gjuhës së shkruar. Në të mirë të kësaj flet edhe përdorimi më i madh i rasteve të para nga përfaqësuesit e brezit të vjetër.

Mbaresat për tri vetat e shumësit janë: *-(e)shin, -(e)shit, -(e)shin*:

ne	<i>qepshim, mblidhshim, futshim, lyshim, ashim, zishim, lashim.</i>
yve(ju)	<i>qepshit, mblidhshit, futshit, lyshit, ashit, zishit, lashit.</i>
ata, ato	<i>qepshin, mblidhshin, futshin, lyshin, ashin, zishin, lashin.</i>

### c) Koha e kryer e thjeshtë

Për formën e pësorës në të kryerën e thjeshtë, për vetën e parë njëjës, kemi një aorist asigmatik, të formuar nga trajta e veprorës me pjesëzën *u* përpara, karakteristike për diatezën pësore: *u zhdryka, u rëfeva, u qepa, u martova*. Kemi hasur edhe një rast aorist sigmatik: *kisha shokë me atë zanat, e braktisa gjer u bëshë 75 vjeç*.

## 2) Mënyra lidhore

Interes dialektor paraqesin vetëm trajtat e vetës së dytë dhe të tretë të kohës së tashme.

Veta e dytë njëjës e foljeve të zgjedhimit të parë e të dytë ka mbaresën *-(ë)sh*: të gjezdissh, të ikësh, të qepsh, të thersh, të brethsh, të psonissh, të prashitsh, të futsh.

Disa nga këto folje kanë si mbaresë vetore afrikaten *ç*, e cila ka dalë nga shkrija e bashkëtingëlloreve *t+sh*, gjë që ka ndodhur në fillim të foljet e klasës së parë, zgjedhimi i dytë si: *fus* lidhore të *fu-tësh*; të *futsh*, të *fuç*. Duke u marrë *ç* si mbaresë e pavarur, doli të *futç*. Këto raste janë më pak të përdorura: të *març*, të *dalç*, të *flaç*, të *futç*.

Këtë mbaresë *-ç* në vetën e dytë njëjës të së tashmes të mënyrës lidhore e kanë edhe dy folje të parregullta: të *veç* dhe të *thuaç*.

Foljet e zgjedhimit të tretë dhe të katërt kanë mbaresën *-sh*: të *kujtosh*, të *shërosh*, të *punosh*, të *thash*, të *lash*, të *bësh*, të *flesh*.

Përsa i përket vetës së tretë njëjës, duhet thënë se foljet e zgjedhimit të parë, të zgjedhimit të dytë dhe të zgjedhimit të katërt klasa e dytë (këto të fundit duke nxjerrë përpara mbaresës edhe bashkëtingëlloren *r* të temës së vjetër) kanë zanoren *ë* si mbaresë vetore: të *qepë*, të *lidhë*, të *bredhë*, të *prashitë*, të *flasë*, të *vrasë*, të *zerë*, të *shpjerë*, kurse foljet e zgjedhimit të tretë dhe ato të zgjedhimit të katërt klasa e parë, kanë mbaresën *-jë*: të *lajë*, të *bëjë*, të *këndojë*, të *tregojë*, të *kërkojë*, të *dijë*, të *ajë*.

## 3) Mënyra urdhërore

Në vetën e dytë njëjës të mënyrës urdhërore foljet me bashkëtingëllore e disa folje me zanore nuk marrin asnjë mbaresë: *fut*, *mer*, *ri*, *pi*, *a*. Foljet e tipit *thaj*, *laj*, dmth. foljet me temë në *-aj*, marrin bashkëtingëlloren *j*: (e cila, sipas M. Domit e Sh. Demirajt, ka dalë në kushtet e hiatusit që është formuar nga enkliza e një përemri enklitik. *tha+e*: thaje dhe pastaj mbeti edhe në rastet kur ky përemër mungonte)<sup>3)</sup> *thaj*, *laj*, *shaj*.

Disa folje të zgjedhimit të katërt, klasa e dytë, marrin mbaresën *ë* dhe ruajnë tingullin fundor *-r* të temës së parë *zerë*, *lerë*, *bjerë*.

Kur tema e foljeve mbaron me zanore, po jo me *-a*, në mes të temës e të trajtës së shkurtër të përemrit vetor nuk del ndonjë tingull anapititik: *bëe*, *dërgoë*, *shikoe*, *shkoe*, *lëshoe*, *kërkoe*. Në disa raste, kur tema e foljes mbaron me zanoren *a*, del një *j* anapititike: *ndaji*, *thaji*, *laje*. Në këtë fenomen, duhet theksuar se vihet re lëkundje. Jo gjithmonë del kjo *j*. Me sa duket, edhe këtu kemi të bëjmë me rimbim kimin e gjuhës së shkruar. Trajta pësore e vetës së dytë njëjës formohet duke i prapangjitur veçores së foljes pjesëzën *u*: *vishu*, *zverdh*, *mbushu*, *zhduku*.

3) M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes (konspekt) leksione*, Tiranë, 1961. Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe (dispencë) II*, Tiranë, 1961.

Në foljet që mbarojnë me zanore, ka raste kur nuk del bashkëtingëllorja antihiatizuese para pjesëzës *u* dhe kjo i ngjitet drejtëpërdrejt temës *ngriu* dhe *ngreu*, *kriu*, *bëu*, *lau*, *kruu*.

### 7. Mënyra habitore

Foljet kalimtare të diatezës veprore si dhe foljet jokalimtare në kohën e tashme të mënyrës habitore dalin me forma gramatikore. të cilat sajohen duke i prapangjitur formës së pashtjellur të foljes themelore, që i përgjigjet pjesores së shkuar, format gramatikore të foljes ndihmëse *kam* në kohën e tashme të mënyrës dëftore. Përsa i takon elementit të parë, do patur parasysh sa vijon:

Foljet e zgjedhimit të parë e të dytë bjerrin çdo prapashtesë të pjesores para foljes ndihmëse *kam*. Foljet e zgjedhimit të tretë dalin me trajtën pa prapashtesë, pa *-rë* e *-r* të pjesores, para foljes ndihmëse *kam*. Foljet që në pjesoren dalin me prapashtesën *-në*, e ruajnë këtë prapashtesë para foljes ndihmëse *kam*, por bjerrin tingullin e saj fundor ë: *apkam*, kur se **urdhëroke** ti djalën; *ziafet e Osmanllisë qënka elmi Shqipërisë*; **qënka** një që mos na jetë; ose po ti **paske** kashtë; **rojtk**a, **qënke** e mirë; sa **plaçka** të mira ke.

Habitoren e tashme e gjejmë të formuar dhe me fundoren *-kërkam*. Kjo mënyrë është më pak e përdorur se rastet e para: ti **bëkërke** çmos me nom në dorë; **paskërke** bërë punë; nuk më **lënkërke** ti dhe punë e madhe.

Në diatezat pësore dhe vetvetore foljet më të tashmen e mënyrës habitore dalin me forma gramatikore analitike të sajuara duke u paravënë formave koresponduese pjesëzën përemërore *u*.

po u **plakërke** të priten këmbët nga pleqëria; u **martuaka** e **rojtk**a; ja na u **dashkan** këto.

Foljet kalimtare të diatezës veprore dhe foljet jokalimtare në kohën e kryer të mënyrës habitore dalin me forma gramatikore analitike, që sajohen duke i paravënë pjesores së shkuar të foljes themelore format gramatikore të ndihmëtares *kam* (në kohën e tashme të mënyrës habitore): *gjyqi* e **paskërka** liruar; *bobo* i mallkuari **paska** bërë *gjyna* të madh; *atere* e **paske** therur; **paska** ikur.

#### 4) Paskajorja

Në këtë të folme paskajoren e hasim në trajtën foljore perifrastike të përbërë nga parafjala për + emër foljor asnjans i pashquar: *vëmë* në klub për të punuar; *shiste tokë* për të vaditur; *i paske bërë shpitë* për të djegur; *kam ca penjë* për të arnuar; edhe ajo për të tallur i tha ajde *bjerë*; *u krijua çeta* për të kërkuar edhe neve streë që të bënim diçka për Shqipërinë; *punonim* për të mbjellë misër me paramenda druri.

## 5) Përcjellorja

Si përcjellore dëgjohe vetëm forma analitike që krijohet nga pjesëza *duke*, ndonjëherë edhe *dyke* dhe pjesorja e shkuar e foljes **themelore**: *po vjen dyke kënduarë; ay këndon dyke punuarë; vinë duke kënduarë; punonim për të mbjellë misër me paramenda druri duke punuar vazhdimisht me kra; duke dëfryer.*

## 6) Pjesorja

Edhe në këtë të folme mbaresat e pjesores janë po ato, që janë vërejtur në të folmet e tjera të Toskërisë Veriore.

Do të bëjmë fjalë këtu vetëm për formën e pjesores që merr pjesë në trajtat foljore të përbëra.

Sipas mbaresave që marrin, foljet ndahen në katër grupe:

1. Në grupin e parë bëjnë pjesë foljet me bashkëtingëllore që kanë aoristin në *-a*, *-ta* ose *-jta*; këto në pjesore kanë mbaresën *-ur*, *erdhur*, *mbetur*, *vajtur*, *vdekur*, *equr*, *nakatosur*, *gjetur*, *ngritur*, *vargosur*.

2. Në grupin e dytë hyjnë foljet që e bëjnë aoristin me *-va* ose *-ra* (janë folje që u mbaron tema me zanore), këto kanë mbaresën *-rë*: *punuar(ë)*, *vrarë*, *shkrirë*, *prerë*, *gëzuarë*, *martuar(ë)*, *pirë*, *prerë*, *ruar(ë) sharë*, *bërë*.

3. Në grupin e tretë hyjnë foljet që mbarojnë me *më*. Këto folje janë të gjitha të parregullta e gjysëm të rregullta: *vënë*, *zënë*, *qënë*, *lënë*, *shpënë*.

4. Në grupin e katërt hyjnë foljet që aoristin e bëjnë me apofoni dhe që u mbaron tema me *r*, *rr*, *l* ose *ll*. Këto folje kanë në pjesore një trajtë të thjeshtuar, e cila sot del në *-ë*, *dalë*, *marë*, *mbjellë*, *sjellë*, *nxjerë*, *fështjellë*.

## NDAJFOLJET

Po kufizohemi duke vënë në dukje vetëm disa nga ndajfoljet më të përdorura në këtë të folme, një pjesë e të cilave janë karakteristike edhe për të folmet fqinje me të.

1. Si ndajfolje vendi më të përdorura po përmendim: *aty*, *këtu*, *atje*, *këtej*, *andej*, *brenda*, *jashtë*, *poshtë*, *lart*, *andezaj*, *këtezaj*, *gjëkundi*, *matanë*, *mënjane*, *thellë*, *përpara*, *prapa*, *përjashta*, *përpjetë*, *ngado*, *përdhe*, *gjetkë*, *sipër*, *brenda* *përbrenda*, *reth e rotull*.

2. Ndër ndajfoljet e kohës më me interes për të folmen e Bulgarëcit janë këto, qofshin ndajfolje të thjeshta apo lokucione ndajfoljore: *æere*, *atere*, *afere*, *atferë*, *aternalaj*, *atfernalaj*, *sefte*, *sot*, *nesër*, *pasnesër*, *të nesmet*, *mot*, *sivjet*, *qëmoti*, *tashi*, *pasdreke*, *pasaj*, *papastaj*, *në mëngjez*.

3. Ne kemi regjistruar një numër jo të paktë ndajfoljesh e lokucionesh ndajfoljore mënyre: *ashu, këshu, reat, veç, tok, drejt, dreq, shpet, ngrotë, njësoj, avash, njëeresh, fsheurisht, ngavash, dreq e dreq, copë-copë, mirë e mirë, fët e fët, më të thatë, me zor, mezi, me zemër, me të pabesë, me nge.*

4. Ndajfoljet e sasisë nuk paraqesin interes të veçantë dialektor. Megjithatë po renditim disa prej tyre: *shumë, ca, një çikë, plot, iç, mja, njerë.*

### PARAFJALËT

1. Me rasën emërore përdoren parafjalët: *nga (dhe ngaj), te, de: rashë nga shkalla, vinin burra nga kurbeti, ata duallë nga Ormani, ngaj nusja, iknin nga keneta, zbret nga kali.*

Parafjalët *te, de*, përdoren më dendur për të ndërtuar plotësa vendi, duke treguar ku kryhet veprimi a ndodhet një send: *mu te porta, kam sjellë edhe lopën te dera, lonte de pusi, i vinte de krevati, de gruri.*

Në lidhje me raportin e përdorimit të varianteve të këtyre parafjalëve *nga/ngaj, te/de* duhet të theksojmë se te brezi i vjetër kanë përdorim më tepër *ngaj, de*, kurse *nga, te* përdoren më tepër si rezultat i ndikimit të gjuhës së shkruar.

2. Me rasën kallëzore përdoren parafjalët *në, ndë, dë*, për të ndërtuar plotësa vendi statikë e dinamikë si dhe plotësa të tjerë: *kam qenë dë slllogjet e gjata; kam patur katër vllëzër ndë Amerikë; e vranë ndë Çiflik; në çdo arë mbin; ay Koli mbet andej në Amerikë; më parë ishte dë Kavajë tashi është dë Durës.*

Përdoret me rasën kallëzore edhe parafjala *m(ë), (mbë)*, e cila shërben për të shprehur marrëdhënje vendi: *m robot, më shpi, më një sofër, më një misur, me një shtëpi anim; më këtë anë; të më ngrësh një pallat mbë udhë kryq.*

Të njëjtin funksion kryejnë edhe parafjalët *përmbi, ndën, ndëpër, dëpër, ndër, nëpër*: *shkon ndëpër fshat, qenë dëpër shtëpitë, e dinë ndë ato nofuska, ndëpër zyra, nëpër këto vise, përmbi lëmënj, ndër neve, nëpër bejlerët, ndër këmbë, kemi ndenjor gjashtë muaj ndënë greknë.*

Një përdorim të gjërë ka edhe parafjala *për*, me të cilën ndërtohen plotës qëllimi, shkaku etj. *për këtë mundim; për qymyr apo për dru; e bëri për qepë e kripë; e bëjmë fanella për vete; për seir venë; janë trima, të zotërit për çdo gjë.*

3. Parafjala *pe* e rasës rrjedhore ka një përdorim të dendur: *pe druri, pe ekuri, pe Korçe, ky druri pe murizi/ bam e bum pas kurizit; djalë pe mbreti; pe bakri, lakrori pe misri; kjo është pe dere të mirë; pagurkat ishin pe alumine.*

Rrallë e hasim të përdorur parafjalën prej te brezi i vjetër.

### LIDHËZAT

Si lidhëzë bashkërenditëse përmbyllëse me një përdorim deri diku të mirë hasim lidhëzën *pandaj*: *s'kishim ku vinim pandaj detyroshim që punonim shumë.*

Si lidhëza shkakore përdorim të dëndur ka lidhëza *ce* (se, sepse): *babaj më shante ce gjezdis këshu; rojen e kam bërë të mirë ce punonim edhe më shpi; nuk llafossha ce ngrisha që në mengjez; e zvogëlova ce më kërkuan ushtar.*

### P J E S Ë Z A T

Nga pjesëzat treguese po shënojmë *ja* dhe nga pjesëzat përforcuese *tipki, tamam; ja më kanë lënë time motra këtu, atje është një djalë memec dhe i bie qitharës tipki si po bie një muzikë këtu.*

Si pjesëza dyshimi përdoren: *mos, dot, vallë.*

Pjesëza e mohimit *nuk* del në trajtat *nuku e nuk; nuku kam mësuar iç; nuk e pa iç fare.*

### P A S T H I R M A T

Disa nga pasthirmat që shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit janë: *o bobo, pupu, o, aman, ua, o medet medet, oo: o bobo i mallkuar paske bërë gjyna; pupu tha ajo; aman o bir; o më rëntë pika; kapedan Smail o medet medet.*

Pasthirmat *mor, o, moj, orë, or, more, mo, forca-forca, o burra o burra lum, e mo bre,* shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.

### F J A L Ë F O R M I M I

Ne këtu do të kufizohemi të bëjmë fjalë vetëm për disa raste të formimit të fjalëve që na duken më me interes dialektor.

1. Me parashtesën *pa* formohen mbiemra të prejardhur nga mbiemra, që marrin kuptim të kundërt, dhe mbiemra nga emrat: *të patundura, i pamartuarë, të paprishur.*

Parashtesa *s* në këtë të folme është kthyer në *c : cbyth, u cbathz, cvirdhet, cgjat.*

Parashtesa *sh*, me variantet fonetike *ç, xh*, në pasojë të asimilimit a përshtatjes së saj sipas tingujve që ka pas, u jep foljeve kuptim të kundërt: *shplodhemi, çlodhet, xhvishnin, xhvishen, çmbrej, çkarkohem.*

Përdoret parashtesa *për* zakonisht me një kuptim përforcues: *përshaj, përhap, përflas.*

2. Karakteristikë dalluese, ashtu si në gjithë të folmet e qarkut të Korçës, janë prapashtesat e zvogëlimit dhe të përkëdhelisë. Të tilla janë prapashtesat sllave (bullgare) *-kë, -çkë: shqerkë, shportkë, blluskë, këmishkë, misurkë, nuskë, krërkë, dyqankë, gjymkë, koshkë, lulkë, kapellkë, bardhaçkë, paraçkë, shamçkë, jastëçkë.*

Duhet të shtojmë akoma se shumë herë prapashtesa *-kë* shërben për të formuar emra femërorë nga mashkullorët: *ariushkë, krishterkë, lanetkë, kaurkë, balashkë, evgjitkë, orkë.*

Përdoret në ndonjë rast edhe prapashtesa *-zë: njëzë, cazë.*

Në këtë të folme gjejmë edhe prapashtesën sllave *-icë*, që zakonisht u shtohet emrave të përveçëm të burrave për të emërtuar gratë e tyre: *Gjelevicë, Periklicë, Lonevicë, Zepericë.*

Gjejmë të përdorura edhe prapashtesat sllave *-ik, -nik* : *pasanik, petanik, dhallanik, sodanik*.

Kemi gjetur të përdorur, ndonëse më rrallë, edhe prapashtesën tjetër sllave *-ovinë*: *mëshqerovinë, kotecovinë, baltovinë*.

3. Prapashtesa *-eshë* përdoret për të formuar gjininë femërore nga mashkullorja: *mbretëreshë, trimëreshë, arixheshë, prifteshë*.

Shpesh përdoren edhe prapashtesat turke *-xhi, -llëk*, që shërbejnë për të treguar profesion (*-xhi*) apo cilësi a rezultat: *hallvaxhi, dyqanxhi, armaxhi, kallanxhi, miqsillëk, bostanllëk, budallallëk, buqsi-llëk*.

Me prapashtesën *-shëm* formohen mbiemra nga emra, ndajfolje dhe folje: *i rrezikshëm, i vlefshëm, i ndryshëm, i sjellshëm, i qëmotshëm, të tanishme, e aterëshme, i avashëm*.

Me prapashtesën *t(ë)* janë formuar mbiemra: *i nxehtë, i ftohtë, e paktë, tepsi të bakërt*.

Tek mbiemrat haset dhe prapashtesa *-më*: *i jashtëm, i prapmë, i përparmë*.

Në një rast kemi hasur edhe prapashtesën *-ak*: *motak*.

Me prapashtesën *-(i)sht* formohen një numër ndajfoljesh mënyre: *zakonisht, pjesërisht, vullnetarisht, vazhdimisht, fsheurisht, greqisht, turqisht*.

4) Nga aglutinimi ose përngjitja formohen fjalë të tilla si: *sivjet, aere, gjëkund, mirpo, ndonjë, sapo, sikush, nëqoftëse, gjëkund, medomosdo, sot, qëmoti, atëfere, përmbi, veçse, medoemos, menjëherë, megjithqë*.

Gjatë ekspeditës mundëm të konstatojmë këto lloj kompozitash:

a) emër + emër: *gjësend, postëbllok, zemërluan*

b) emër + emër foljor: *udhëeqës*

c) emër + mbiemër: *dijshkurtër, syzezë*.

ç) numëror + emër + prapashtesë: *pesëlekshi*.

## SINTAKSË

1. Në të folmen e Bulgarecit, ashtu si në shumë të folme të tjera të rrethit të Korçës, emri i rasës kallëzore me funksionin e plotësit të vendit, në shumicën e rasteve ndërtohet pa parafjalën *në*: *do të veç Korçë se të kërkojnë; më shpuri Korçë; e odhë Bilisht*.

2. Vihet re se pas parafjalëve *pe* (prej) dhe *pas*, një emër ose një përemër mund të jetë edhe në rasën kallëzore: *ik pe mua thoshte; pe atë copën që shitet këtu; ay vinte pas mua*.

3. Plotësi i vendit i rasës emërore me parafjalën *tek* gjendet në formën: *këtu ndër neve nuk bëri gjë; gjer ne kisha; i bënte seir në penxherja; nuk ardha dot të mershe vesh nga tynë*.

4. Ashtu si në të folmen e Korçës edhe në atë të Bulgarecit ndajfolja e vendit, që lot rolin e plotësit të vendit, merr shpesh parafjalën *pe* në vend të pjesëzës përforcuese *që*: *pe këtu gjer de çezma; pe andej vinte, pe nga vjen ti o bir*.

Parafjalën *pe* e gjejmë të përdoret para një emri ose përemri që lozin rolin e një plotës vendi ose shkak. Por ka raste kur gjejmë të përdorur edhe parafjalën *nga*: *s'e bënja dot se kisha frikë pe babajt; rëzoshim pe fushe; pe atij sdo tja dijë; rashë nga shkalla*.

5. Në këtë të folme, kur kryefjala është një emër kolektiv, kallëzuesi më të shumtën e rasteve, është një folje në numrin shumës: *ngrishin e shkonin krushqia; familja shpinin petulla do ti lëshonin nëpër sofa.*

Gjejmë ndonjë rast, kur kryefjala e shprehur me emër merr si kallëzues një folje në numrin shumës: *këta ushtëria vanë e i pandyen puntorë; e kanë rrethuar Bulgarecin asqer i Turqisë.*

6. Ka raste kur një fjali e varur kushtore ndërtohet edhe me lidhëzën *po* dhe me një folje-kallëzues të mënyrës dëftore në kohën e tashme: *po svjen turku, vjen greku; po ske mall dë shpi s'bën dot gjë.*

7. Është për t'u vënë në dukje se në të folmen e Bulgarecit, përveç formës së zakonshme të ligjëratës së zhdrejtë, që është më e përdorura, gjejmë një trajtë tjetër, ku ligjërata e huaj, megjithëse riprodhohet besnikërisht, bashkohet nëpërmjet lidhëzës nënrenditëse *se: i thotë ay se: unë jam buri i filankës e qeshë njëzet vjet në kurbet.* Nuk kemi gjetur raste, kur para ligjëratës të vihet lidhëza që. Por mendojmë se edhe kjo mënyrë duhet të jetë e përdorur.

#### KONKLuzion

E folmja e katundit Bulgarec, ashtu si e të gjithë fushës, është një e folme e toskërishtes veriore e trevës së Korçës. Ajo ka këto karakteristika kryesore:

1. Zanorja *e* e theksuar e ndodhur para bashkëtingëlloreve hundore në shumicën e rasteve nuk është kthyer në *ë: embër, e enjte, e premtë, femër, zembra*, por ka dhe raste kur kjo zanore është kthyer në *ë: mëndje, nënt, vënë, gjëmbi.*

2. Zanorja *ë* e patheksuar ruhet në shumë pozita dhe në të shumtën e rasteve edhe zanorja *ë* paratheksore, pavarësisht nga numri i rrokjeve që ka fjala.

3. Kur grupet e zanoreve *ua, ye, ie*, ndodhen në rrokje të mbyllur dëgjohen aty-këtu edhe si diftong: *thuan, kuajt, dyer, pyet, mbiell, ziej, tier.*

4. Bashkëtingëllorja *h* nuk ndihet: *ëna* (hëna), *ëngra* (hëngra), *ipa* (hipa), *atere* (atëhere), *muabet* (muhabet), *gjua* (gjuha), *bëet* (bëhet) etj.

5. Bashkëtingëllorja paragjuhore *rr* nuk bën pjesë në sistemin e fonemave të kësaj të folmeje, po ashtu si dhe në të folmen e qytetit të Korçës. Këtu ekziston vetëm bashkëtingëllorja *r*.

6. Fenomeni i reduktimit të grupeve *mb, nd* vërehet vetëm te parafjalët, ku përkatësisht kanë dhënë *b, d*.

7. Grupet *rn, tn, thn, lln, sn* janë asimiluar dhe kanë dhënë *r, t, th* (dh), *ll, z*.

8. Fenomeni i shtesës shfaqet me shtimin e një bashkëtingëlloreje hundore në fillim të fjalës: *mbesoj, u ntrash*; të një bashkëtingëlloreje hundore në mes të fjalës para një bashkëtingëlloreje buzore ose dhëmbore: *fambrikë, andresë, ambullancë, njëndizaj*; të bashkëtingëllores *b* në mes të grupit *mr*: *dimbri, fembra, thembra, embri, zembra.*

9. Vihen re edhe raste të rënjes së tingujve: *qumshi* (*qumështi*), *pasaj* (*pastaj*), *shpi* (*shtëpi*), *mja* (*mjaft*), *tashi* (*tashti*) etj.

10. Ende ruhet e gjallë gjinia asnjansë e emrave, sidomos e atyre që tregojnë lëndë.

11. Një grup emrash që zakonisht tregojnë frymorë, e formojnë shumësin me mbaresën -ër: *evlat-evlatër, gjysh-gjyshër, mbret-mbretër*.

12. Emrat mashkullorë të numrit njëjës e formojnë trajtën e kallëzores së shquar, duke marrë -në drejtpërsëdrejti pas temës së emrit të pashquar: *kanë, kollozheknë, plisnë, suratnë, fshanë*.

13. Në numrin shumës, veç trajtave letrare, *ne, ju* të rasës emërore përdoren dendur trajtat e gjindore-dhanores *neve, yve*. Kurse përemrat vetorë të vetës së dytë dhe të tretë njëjës *ti, ay* ka raste që në rasën emërore njëjës të hasen me trajtat *tinë, aynë*, si duket për analogji me përemrin vetor të vetës së parë njëjës *unë*.

14. Mbiemrat pronorë kanë formë të njëjtë në të gjitha rasat. Kjo duhet të ketë ardhur si rrjedhim i përhapjes analogjike të rasave të zhdrejta në rasën emërore.

15. Për trajtën e vetës së tretë të numrit njëjës të foljeve me zanore në të kryerën e thjeshtë është karakteristike ndërkallja e bashkëtingëllores, antihiatizuese *v* midis temës dhe mbaresës: *shivi, lavi, arovi, kërkovi, kalovi, lëvdovi, qavi previ, lëshovi*.

16. Edhe veta e tretë njëjës e së pakryerës të formës pësore ka mbaresën -(e)she, ashtu si veta e dytë njëjës.

17. Foljet e zgjedhimit të parë dhe të dytë në vetën e dytë të kohës së tashme të mënyrës lidhore kanë mbaresën -(ë)sh.

18. Parafjala *pe* e rasës rrjedhore ka një përdorim të gjerë: *pe druri, pe ekuri, pe Korçe* etj.

19. Hasen dendur prapashtesat e zvogëlimit dhe të përkëdhelisë me origjinë sllave -kë, -çkë: *shqerkë, shportkë, blluskë, misurkë, krërkë, lulkë, paraçkë, jastëçkë*.

20. Emri i rasës kallëzore me funksionin e plotësit të vendit në shumicën e rasteve ndërtohet pa parafjalën *në*: *më shpuri Korçë; a odhë Bilisht*.

21. Pas parafjalës *pe* (prej) dhe *pas* një emër ose përemër mund të jetë edhe në rasën kallëzore: *ay vinte pas mua; pe atë copën që shitet këtu*.

22. Ndajfolja e vendit që lot rolin e plotësit të vendit, merr shpesh parafjalën *pe* (prej) në vend të pjesëzës përforcuese që: *pe andej vinte, pe nga vjen ti o bir*.

23. Ka raste kur një fjali e varur kushtore ndërtohet me lidhëzën nënrenditëse *po* edhe me një folje-kallëzues të mënyrës dëftore në kohën e tashme: *po ske mall në shpi, s bën dot gjë*.

Veçoritë dialektore që vumë në dukje në këtë punim na bëjnë të shfaqim mendimin se e folmja e këtij katundi si në fonetikë, morfologji, sintaksë dhe në leksik ka veçoritë më kryesore të toskërishtes veriore e në mënyrë të veçantë të trevës së Korçës. Në pjesën më të madhe kjo e folme ka mjaft pika takimi me të folmen e Korçës si qytet dhe të Devollit dhe më pak me atë të Oparit<sup>4</sup>. Një studim i hollësishëm i së folmes së Korçës si qytet, ndofta do ta jepte më qartë këtë tablllo. Na duket me vend të theksojmë se mjaft nga këto karakteristika nuk janë të qëndrueshme dhe shpeshherë vihen re luhatje jo vetëm tek brezi i ri, por edhe tek të moshuarit. Kështu: lu-

4) Shih për këtë: J. Gjinari, *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT, Seria Shk. shoq. 1957, 1, f. 134-164; po ay, *Mbi të folmen e Devollit*, BUSHT, Seria Shk. Shoq: 1960, 4, f. 103-131; V. Xhaçka, *Një shikim mbi të folmen e krahinës së Devollit*, BUSHT, Seria Shk. Shoq., 1958, 2, f. 196-209.

hatja e zanores e të theksuar para bashkëtingëlloreve hundore që herë kthehet në ë herë jo; shfaqja në disa raste e bashkëtingëlloreve për të prishur hiatusin te emrat femrorë oksitonë; përdorimi i emrave të lëndës edhe si emra të gjinisë mashkullore; shfaqja në mjaft raste, në rasën kallëzore njëjës të trajtës së shquar, e zanoreve *i ose u* midis temës e mbaresës; mungesa disa herë e bashkëtingëllores *v* në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë; mbaresa *-ej* në disa folje të vetës së tretë të numrit njëjës të kohës së pakryer të pësorës; përdorimi i disa ndajfoljeve të kohës, vendit, mënyrës, sasisë, i disa lidhëzave; formimet me *-shëm, -isht* e raste të tjera, të çojnë në përfundimin se ndikimi i gjuhës letrare edhe në këtë të folme, si për të gjitha të folmet e shqipes, është i ndjeshëm dhe i shumanshëm dhe se rrafshimi i veçorive dialektore, përhapja e gjuhës letrare është një proces i pandalshëm.

### TEKSTE

«... po të kujtosh të parat / ka ndryshuar bota // po të kishe pesë leka në qese / të dilte ajduti // më iku djali vogël // ata e muar vesh më përpara / e më të nesmet më vinë // djalin e kisha dërguar me dhën / -neve do të djegim shtëpitë // i paske bërë shtëpitë për të djegur // nuku ke as gjalpë as mjell as vaj // je ndër mend / evlatër ke vetë // do të veç në Korçë se të kërkojnë ata të mëdhenjtë // më shpuri Korçë // yra de xhuvapi // pe nga ka ikur më tha / e ke dërguar ndë çetë // mund të ketë shkuar i thashë // kur se urdhëroke ti djalin kush e urdhëron // neve do të apim një lejë të shkosh // mi kishnë marë me dhën me lopë // kush i ka marë / me çizë i muarë bagëtinë / i pikasnë dhëntë // e odhë Bilisht // qëkur yri atje është tronditur shumë //

Miti Plasari

82 vjeç

«... aty erdhi Frënca e shpartalloi ca krerë si Qamilë / Themistoklinë // papastaj u ngrit një si Shqipëri / kështu që vinte një shkretëtim se aere vazhdonin ndë këtë mënyrë // në atë kohë kur ishte Rexhep Alla / në Korçë sundonin gjithë këta krerët / sidomos me Themistoklinë // ja kishte thënë që / dë e zënça Themistoklinë / do ja mbush lëkurën me kashtë // po Themistokliu e mori vesh // me shokët e tij bëri pllan // Rexhep Allën do ta vrasmë u tha // dë pllanë e tija mori dy djemka të vegjël e u dha nga një revole // i dërgoi brënda de Rexhepi / duke patur fshehur revolet // u thotë çap i bini Rexhepit / jo që ta vrisni / po të ngrihet më këmbë me lebeti // ja kish zënë pusinë dë qoshet // ay doli me vrap dë derët të kafenesë // e vravi dë vënt //

neve buqër pa tokë nëpër belerët punonim // qoftëse s ja lanim dot borxhin / atere na mbante gjith atë që bëshe edhe ik pe mua theshte // iknim po dë një tjatër si ay do vinim gjene // po kjo ngjiste me çdo bej // punonim gjith / të mëdhenjtë edhe të vegjlit prapa // puna dukshe e rëndë / ca punonim me plugje pe druri // detyrosim që punonim shumë / e anim pak // me mbjelljen / me prashitjen / me të tëra aty e ndanim me bejnë // ja shpinja pjesën beut ku i dushe / pastazaj tjatrit e mernja //

Aere qeshë kalama i vogël dë pelenat ose të thuash më mirë dë shtytkat fare // tashi jam dë nofuskë 1900 / jam edhe më i madh po e zvogëlova ce më kërkovi Zogu ushtar // baba tim kishte një motër për të martuarë / e ja kërkonin në koë martesë më nja dy vënde / po s kish si ta jepte / sepse nuku mund të bëshe punë // ata që e deshnë e zunë Smail Dërdushën / dhe i thanë kshu e kshu e kemi allë / ti mund të na i mbarosh këtë punë / pa neve për tynë // aere ay ngriet e vjen natën në shpi // ape derën thotë // baba do ta epte se s bënte // a më nje mua / i tha / po të njo // unë kam ardhur se tinë ke një motër për të martuar / e do ta japsh dë filanë // të lutem kapedan / mos më bjerë dë qeder për këtë punë // mua më thonë Smail Dërdusha / llafi tem nuku bëet dy // po ik unë / po gjer pasnesër kjo punë të marë funt // baba tem u zu ngushtë // mejtoej si t ja bëj e qysh t ja bëj // kur më javët veti shtatë a tetë erdhi // të thashë llafi tem s bëet dy /

Nuni Sotir Gorari  
63 vjeç

«... bënim dasma ndë aurt të bagëtive / më dy anët grazhde // pagurkat ishnë pe alumine // bardhaçkave u theshin legjenka // shtro-  
nim sofra / e shtroshim me radhë / nisshe dasma që të premtë / e mbaronte të mërkurë // ftonim kumbaren / e bënim kulaçnë // të premtë mbrëma / shkonim të ftonim kumbaren dhe vllamnë // pastaj të shtunë nisshin / po ta kishnë nusen në fshat // të enën bënte kumbarja trapeza me petulla / dhe pinin me kolozhek // kishnë edhe kupa // të mërkurë lonin / bënin ziafet // të shtunë nisshe dhëndri / vinte të ftonte fshanë / me kulaçe me vëra në mest // nisshe familja e shpinin petulla / do t'i lëshonin nëpër sofra // ay do ta bënte sukliash // bënte të parë i ati i nuses / edhe do t'i fuste dë aurt // mirrnin kungulleshkat // ngriu dhëndër të thershe pulat // e ngrishë dhëndri // kishte njerëz që deshte t'i therte të gjitha / pastaj zishin / rishin / e ikte dhëndëri // miqtë mbetshin të zemruar // dhëndrit i bënte vjera vezë të tiganisura // kishte rast që zemroshe krushku // ay merrte një kulaç më torbët / dhe duet tja thyente nuses në kokë // nusja shkonte më të majtë / edhe dhëndëri i binte me grusht / që t'i ketë frikë nusja // papasaj kur vajtnë andezaj krushqit nuk i qasnë // ata u shtruan mund atje de kisha //

Afroviti Riza  
60 vjeç

«Unë arova / u plaka jam tekayk // tinë në shkollë je o // vajta e pashë die nusen // kur më shpinin brenda ma futnin brenda atë njerinë // tashti e she dhe s'ka gojë të më thotë // më parë mbyllnje sytë / tashti i pëlqejnë vetë // i them e më bije të pëlqen // çarë prallë të të rëfej si më muar nuse // ja më suall një çarçaf me një perçe edhe ma muar frymën // më vunë një vello të kuqe pe atë copën që shitet këtu // më suallë një llandon e më muarë // unë e shkreta isha e mirë e mentonja turpin // ajo më mori për kunanë / tashti po se pashë vetë thotë çupa se mar / si të thoshnja unë këshu // shiko çarë istori moj e zezë // po të dilnja jashtë mua më rinin // kur delnja / delnja me çarçaf / dilnin tërë krishterkat /».

Ferdane Plepi  
54 vjeç

«... e kanë rrethuar Bulgarecin asqer i Turqisë / çetat shqiptare atje kishin vajtur // ka qenë koë lëmi // ca flinin e ca qenë brenda / e këta ushtëria vanë e i pandyen puntorë / ata u ngritnë papastaj e u përfytnë // këta qenë brënda ndë një dhomë // i zunë gjashtë veta e i pushkatuanë // këtu nuk u gjënd gjë / vetëm se ishte një armaxhi / do lidhte duaj / i ranë po nuk e vranë // ata duallë nga Ormani // ay pa atë ushtërinë e po ikte për më shpi / ce kish lëshuarë bagëtinë // ka qenë ditë e shtunë // më 1908 u falë çetat shqiptare // yri sulltan Memeti / e i lëshovi burgjet // populli tërë u mblodh / bandat binin // baballarë / oxhallarë / priftinjtë / këtu u mblodhë // pasazaj u bë lufta // i kërkuanë luftë këta / po aere s kish maqina / edhe u shpartalluan // Më tri javë dë Devoll dogji pak / ku u nkëthye prap // këtu ndër neve nuku bëri gjë // që atë natë që yri Korçë / ardhi e Bulgarec / e na futnë dëpër ca shtëpi // më të nesmet i mblodhi ushtërinë tërë dë mulli / e na mblodhi edhe neve tërë fshanë // mirpo topi po binte n Qar akoma // ç kini për të bërë / bëni u tha // e mor Gaqi folë / thotë një plak / në kemi bërë gjësënd // neve kemi shkuarë si vëllezër / e do shkojmë // jep urdhër oficeri t i ndani ushtërinë pas fuqisë që kanë // pas tri javësh erdhi ushtëri tjetër // na mblodhi de mulliri të gjithëve // një takëm duallë / ca qenë dëpër shtëpitë // s llafosim dot or djalë // kemi equr të zit e ullirit //»

Dilaver Demir Agolli  
68 vjeç

### *Fragmente përralle*

«... qënka një që mos na jetë // ishin tri motra e s kishin as nënë as babë // një e qüanin Zylkade // dilnim pyesnin ënën // enë moj enë / kush është më e mirë tinë / a unë / a Fatimeja / a Zylkadeja // më e mirë se Zylkadeja as unë as tinë / thosh ëna / këtë e bënë të zezë / që të mos dukej e mirë // e kanë pyetur natën e dytë // ajo gjene ashtu u tha // tashti këtë e kanë lyer edhe me balgë / edhe ajo gjene ashu u tha // si ta umbisnin // bënë një kuaça pe iri e vanë dë malt // e po të amë ca bukë e të çlodhemi thanë // rëkëllyen kuaçin poshtë / e i thanë / shko Zylkade / çapë / se na ra // vajti e mori / dhe kur ardhi qante / se ato kishin shkuar // vjen një ari // ç'bën këtu moj motër maro // po ja / më kanë lënë time motra këtu / e s di nga të shkoj / jam vetë // iqmë mua për ti / të bëj një ariushkë / e ta lë të rish me të // ajo e oqi për bishti // më pas / ka ardhur një çoban me dhen // vajti dhe një dele // edhe delja i tha si ariu // ajo e oqi për bishti / e bëri një shqerkë // ja la shqerkën / dhe çobani i dha bukë // u rrit kjo shqerka / e kjo anavasi dy shportka / dhe ja vinte më briskat / dhe vinte dë një vreshtë / këputte rush / e ja sillte / e anin tok // kur vjen i zoti që ruante vreshtën / e zë atje / edhe i bie pas shqerkës // vajti atje e gjeti Zylkadenë // ç je ti këtu në malt // ay qe një i pasur / pastaj i tha ajde / po të duash / të të mar unë grua / e mos ri këtu dë malt // vij / po të mos e therësh shqerkën // ju betua ay që nuk ta ther // e muar vesh të motrat që u martuaka e rojtka // u veshnë si evgjitka / që shisnin plaçka / e vajtnë ta umbasin atje // ajo si njou // kemi plaçka për të blerë // njëra thotë mua më piet ujë / tjetra i thotë sa plaçka të mira ke i këmbejmë // ajo veshi të sajat

ajo të sajat // unë dua ujë pe pusi // kjo me marifet e odhi në pus  
 Zylkadnë // ajo tjetra shkoj / e ishte si më vent të saj // kjo i tha që  
 there këtë shqerë // ay vajti mori kasapnë // shqera vinte rreth pu-  
 sit // erdhi kasapi e tha se kjo shqerë çdo de pusi // ay tha pa të  
 vete të mar atë çengelnë // ka çesa çengela në fund të pusit // ajo  
 kishte qëndruar më ujët // ajo u zu për litart // ay e tunt litarë e  
 ngre e ngre e kur del evgjitkë // zu lonte ajo shqera de pusi // ajo  
 tha më odhë dë pust //

Ymer Ahmet Avxhi

79 vjeç

### R é s u m é

#### REMARQUES SUR LE PARLER DE BULGAREC (PLATEAU DE KORÇE)

Le but de cette esquisse dialectale est de broser les principales particularités du parler du village de Bulgarec de l'arrondissement de Korçe. Bulgarec se situe au N.-O. de la ville de Korçe, à droite de la route automobile Korçe-Tirana, à environ 5 Km. de l'agglomération urbaine. C'est pour la première fois que le parler de Bulgarec devient l'objet d'un examen dialectal. L'auteur a glané le matériel durant les mois de juillet-août 1963. Voulant saisir dans toute son ampleur le parler traditionnel du village, il s'est tenu aux tests de la génération ancienne.

Cela présent, la description qu'en fait l'auteur n'est pas toute sur le parler d'aujourd'hui, en sa dynamique, avec les mutations qui interviennent dans la génération nouvelle.

Durant la glane du matériel linguistique sur place, l'auteur a questionné quatorze tests, dont au nombre aussi quelques femmes provenant des villages voisins du plateau de Korçe, cela compte tenu que les mariages faits à l'intérieur du village sont rares.

Comme méthode de travail, l'auteur a utilisé surtout l'entretien libre. Mais, lorsque durant cet entretien ne résultaient pas certaines formes grammaticales pour compléter le cadre, il a eu recours aussi à la forme des questions et réponses. Souvent les formes grammaticales ont été enregistrés en deux ou plusieurs sujets, pour constater leur persistance ou bien leur oscillation.

Pour la glane du matériel linguistique, l'auteur s'est limité au seul village de Bulgarec, cela permettant de saisir mieux le parler du plateau de Korçe au moyen de l'investigation profonde dans une de ses agglomérations rurales. Outre l'entretien avec des tests de 50-90 ans, l'auteur a étendu son enquête aussi sur le parler de la génération nouvelle, dans le but de constater les mutations intervenues avec la génération ancienne et les tendances actuelles de l'évolution de ce parler.

Comme il résulte de l'observation de quelques phénomènes linguistiques relatés dans les chapitres sur la phonétique, la morphologie et la syntaxe du présent exposé, le parler du village de Bulgarec, comme celui de toute la plaine, est un parler du dialecte tosque septentrional de la région de Korçe. Les suivantes sont ses principales caractéristiques:

1. L'e tonique, se trouvant devant des consonnes nasales, s'est changée, dans la plupart des cas, en ë.

2. La voyelle ë atone est gardée dans plusieurs positions, et, dans la plupart des cas, aussi la voyelle ë prétonique, indépendamment du nombre de syllabes que compte le mot.

3. Les groupes de voyelles *ua, ye, ie*, se trouvant en syllabe fermée, sont entendus parfois aussi contractés en diphtongue.

4. L'*h* est toujours muet, ou mieux plutôt il est absent.

5. La consonne prépalatale *rr* roulé ne fait point partie du système des phonèmes de ce parler. Il en est de même aussi pour le parler de la ville de Korçe. On n'a ici, à sa place, que l'existence de la consonne *r*.

6. Le phénomène de la réduction des groupes *mb, nd*, est observé uniquement dans les prépositions, où ils ont donné respectivement *b* et *d*.

7. Les groupes *rn, tn, thn, lln, sn* sont assimilés. Ils ont donné respectivement *r, t, th(dh), ll, z*.

8. Est remarqué le phénomène de l'adjonction et de la chute des sons.

9. Est conservé encore vivant le genre neutre des noms, surtout de ceux qui indiquent des matières.

10. Les noms masculins au singulier forment l'accusatif défini en s'ajoutant un *-në* directement après le thème du nom indéfini.

11. Les adjectifs possessifs ont la forme identique dans tous les cas. Cela doit résulter comme conséquence de la diffusion analogique des cas indirects au nominatif.

12. Une caractéristique de la troisième personne du singulier des parlers se terminant en voyelle au passé simple est l'intercalation de la consonne antihiatante *v* entre le thème et la désinence.

13. La préposition *pa* de l'ablatif connaît un ample usage.

14. Sont rencontrées fréquemment les suffixes diminutifs et hypocoristiques d'origine slave *-kë, -çkë*.

15. Le nom à l'accusatif à fonction de complément de lieu est construit, dans la plupart des cas, sans la préposition *në*.

16. Après la préposition *pe(prej)* et *pas* un nom un pronom peut aussi être à l'accusatif.

17. L'adverbe de lieu, qui joue le rôle de complément de lieu, s'adjoint souvent la préposition *pe (prej)* au lieu de la particule accessoire *që*.

Les particularités dialectales faites ressortir dans ce travail par l'auteur le confirment dans l'opinion exprimée plus haut que le parler de cette agglomération rurale a en phonétique, morphologie, syntaxe et lexicologie toutes les principales particularités du dialecte tosqe septentrional, et tout particulièrement de la contrée de Korçe.

Ce parler, dans sa plus grande partie, a plusieurs points de contact avec le parler de Korçe comme agglomération urbaine, et du Devoll, et moins avec celui d'Opar. On doit, pourtant, faire relever que plusieurs des caractéristiques linguistiques ne sont pas durables et que sont observées, souvent, des oscillations non seulement chez la jeune génération, mais également chez les sujets âgés.

Ainsi, l'oscillation de l'*e* tonique devant les consonnes nasales, qui tantôt se mue en *ë* et tantôt non; la manifestation dans quelques cas des consonnes pour rompre l'hiatus chez les noms féminins oxytons; l'emploi des noms désignant des objets matériels aussi comme noms de genre masculin; l'absence, parfois, de la consonne *v* dans la troisième personne du singulier du passé simple; l'emploi de quelques adverbes de temps, de lieu, de moyen, de quantité, de quelques liaisons; les formations en *-shëm -isht* et d'autres cas, portent à la conclusion que l'influence de la langue littéraire sur ce parler, comme sur tous les autres parlers de l'albanais, est sensible et multilatérale et que l'aplatissement des particularités dialectales, la diffusion de la langue littéraire, représentent un processus irréfragable.